UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 2/31
Datë: 30/9/2020

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë, lidhur me procesin e zgjedhjes dhe avancimeve akademike të rregulluara me nenin 173 pika 1 dhe nenit 176 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe në bazë të veprimeve procedurale të rregulluara me nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit nr. 05/l-031 për Procedurën e përgjithshme administrative dhe në bazë të kompetencave të shprehura me nenin 48 të Statutit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 28. 09. 2020 mori :

## VENDIM

1. Konkursi i shpallur nga Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me datën 22.10.2019, nr. 2/872 ka përfunduar në kontekst të afatit ligjor të paraparë sipas nenit 14, pika 4 dhe 5 të Rregullores nr. 2/747, dt. 1.10.2019, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

2. Në nenin 14, paragrafi 6 të Rregullores nr. 2/747, dt. 1.10.2019, është paraparë se në rast se konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 14, atëherë vendet përkatëse të parealizuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së fakultetit. Prandaj mbi këtë bazë, lëndët të cilat kanë qënë të publikuara me konkursin si në pikën 1 të këtij vendimi dhe të cilat për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të trajtohen apo për të cilat nuk është marr një vendim përfundimtar brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 4 dhe 5 të nenit 14 të Rregullores nr. 2/747, dt. 1.10.2019, për emërim, riemërim apo avancim të personelit përkatës akademik, të njëjtat do të rishpallen sipas procedurave ligjore.

3. Personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune i cili ka qenë pjesë e konkursit si më sipër, por që për shkaqe të ndryshme konkursi për ato pozita nuk është përfunduar brenda afatit ligjor, me një vendim për avancim apo riemërim në thirrjen e njëjtë, do të pajisen me kontratë të përkohshme me kohëzgjatje deri në përfundimin e procedurave të konkursit të radhës por jo më gjatë se deri më 30.9.2021.

4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi do të jetë lista me emrat dhe pozitat e personelit akademik që i takojnë kategorisë si në pikën 3 të këtij vendimi, si dhe emrat dhe pozitat e kandidatëve të jashtëm, lëndët e të cilëve janë përfunduar pa një vendim përfundimtar për emërim.

5. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

### Arsyetim

Senati i Universitetit të Prishtinës me datë 22.10.2019, ka shpallë konkursi për emërim, riemërim dhe avancim të personelit akademik nr. 2/872. Senati ka kërkuar që të respektohen procedurat sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren përkatëse, mirëpo duke pasur parasysh kriteret mjaft rigoroze dhe standardet e përcaktuara për emërim, riemërim dhe avancim, disa lëndë nuk kanë arritur që të përmbyllen brenda afatit ligjor për faktin se ato lëndë nga komisionet e njësive akademike nuk janë vlerësuar mbi bazën e kritereve të përcaktuara,

prandaj si të tilla ato janë rikthyer për rivlerësim tek komisionet e njësive akademike dhe këshillat përkatëse. Një numër i caktuar i lëndëve nuk janë vlerësuar fare, apo për ato lëndë nuk janë formuar fare komisione vlerësuese për shkak të problemeve rreth fondit të orëve. Po ashtu disa lëndë nuk janë përmbyllur si rezultat i mungesës së kredive të nevojshme të fituara në studimet e doktoratës jashtë vendit, respektivisht numri i kredive nuk ka qenë në përputhje me nenin 93, paragr.2 të Statutit (180 ECTS Kredi), përkundër faktit që Komisioni Statutar nuk e konteston gradën shkencore "Doktor shkence", por ka dilemë rreth numrit të kredive të fituara në këto studime (60 ECTS Kredi) dhe të drejtës për të marrë statusin e profesorit asistent në UP. Prandaj duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana dhe tejkalimin e afatit të rregullt prej 175 ditësh dhe afatit plotësues prej 30 ditësh të lejuar nga rektori, Senati i UP-së në ditën e 209, vendosi si në dispozitave të këtij vendimi.

**Vendimi t'u dorëzohet:**

1. Arkivit të Universitetit;
2. Dekanëve të Fakulteteve përkatëse;
3. Sekretarëve të Fakulteteve përkatëse;
4. Kandidatëve;
5. Zyrës për Çështje Akademike;
6. Zyrës ligjore;

Kryesues i Senatit të Univiversitetit të Prishtinës

Prof. Dr. Marjan Dema, Rektor

**Kjo listë është pjesë përbërëse dhe e pandashme e vendimit të Senatit të UP "Hasan Prishtina", me numër të protokollit 2/31 të datës 30.09.2020.**

**I. Pozitat e personelit akademik që i takojnë kategorisë si në pikën 3 të vendimit nr. 2/31 të datës 30.09.2020 janë si në vijim:**

**Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore**

**Sipas konkursit me nr.2/872 të datës 22.10.2019 janë pozitat me numër rendor 1, 3, 17, 18 dhe 19.**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Morfologji dhe sistematikë e invertebrorëve I dhe II (O) (Bsc. Biologji), Zoologji e pakurrizoreve (O) (Bsc. Ekologji dhe mbrojtje e mjedisit), Makrozoobentosi i ujrave të ëmbla (Z) (Msc. Ekologji dhe mbrojtje e mjedisit), Kapituj të zgjedhur nga zoologjia e invertebrorëve (O) (Msc. Biologji), Ekologji humane (O) (Bsc. Ekologji dhe mbrojtje e mjedisit).

2. Një mësimdhënës për lëndët: Ekologji e përgjithshme (O) (Bsc. Ekologji dhe mbrojtje e mjedisit), Hidrobiologji (O) (Bsc. Ekologji dhe mbrojtje e mjedisit), Bazat e Anatomisë dhe fiziologjisë së njeriut (Bsc. Biologji), Biologji (O) (Bsc. TUBT-FBV), Ihtiologji (Z) (Msc. Biologji), Limnonolgi (Z) (Bsc. Biologji).

3. Një mësimdhënës për lëndët: Klimatologjia me Meteorologji (O) (Bsc. Gjeografi), Gjeomorfologjia I (O) (Bsc. Gjeografi), Gjeografia Nacionale I (O) (Bsc. Gjeografi), Gjeomorfologjia aplikative (O) (Msc. Gjeografi), Menaxhimi i Resurseve natyrore (O) (Msc. Gjeografi).

4. Një mësimdhënës për lëndët: Demografi (O) (Bsc. Gjeografi), Migrime (O) (Bsc. Gjeografi), Resurse Humane (O) (Bsc. Gjeografi), Gjeografia Nacionale II (O) (Bsc. Gjeografi), Analiza Demografike (Z) (Msc. Gjeografi).

5. Një mësimdhënës për lëndët: Gjeoekologjia (O) (Bsc. Gjeografi), Gjeografia e Vendbanimeve (O) (Bsc. Gjeografi), Planifikim Hapësinor (O) (Bsc. Gjeografi), Menaxhimi i hapësirave urbane dhe rurale (Z) (Bsc. Gjeografi), Menaxhimi i mjedisit (Z) (Bsc. Gjeografi).

**Fakulteti i Filologjisë**

**Sipas konkursit me nr.2/872 të datës 22.10.2019 janë pozitat me numër rendor 4 dhe 5.**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Morfologji I (Sistemi emëror i shqipes) (O), Morfologji II (Sistemi foljor i shqipes) (O), Radiogazetari (O), Psikolinguistikë I (O), Psikolinguistikë II (O), Fjalëformimi (Z).

2. Një mësimdhënës për lëndët: Mesjeta dhe Renesanca (O), Klasicizmi dhe Iluminizmi (O), Romantizmi, Realizmi, Simbolizmi (O), Letërsi e krahasuar (O), Letërsi dhe kinematografi (Z).

**Fakulteti Ekonomik**

**Sipas konkursit me nr.2/872 të datës 22.10.2019 janë pozitat me numër rendor 3, 6, 8, 9 dhe 14.**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Financa ndërkombëtare (O), Ndërmarrësi (Z), Tregjet financiare (O), Tregjet dhe institucionet financiare (O).

2. Një mësimdhënës për lëndët: Marketing (O), E-marketingu (Z), Sjellje e konsumatorëve (O), Sjellje e konsumatorëve II (O).

3. Një mësimdhënës për lëndët: Makroekonomia I (O), Ekonomiksi i zhvillimit (O), Economic Development (gj.angl.) (O), Ekonomiksi i sektorit publik (Z), Ekonomiksi i dijes (Z), Ekonomiksi i rritje së zhvillimit (O).

4. Një mësimdhënës për lëndët: Mjedisi në biznes (Z), Hyrje në biznes (Z), Ekonomiksi i tregut të punës (O), Ekonomiksi monetar (O), Etika e biznesit dhe përgjëgjësit sociale (Z).

5. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në biznes (Z), Principles of management (gj. Angl.) (Z), Menaxhimi i BVM-ve (O), Menaxhmenti i investimeve (Z), Menaxhmenti strategjik (O).

**Fakulteti i Ndërtimtarisë**

**Sipas konkursit me nr.2/872 të datës 22.10.2019 janë pozitat me numër rendor 1.**

1. Nje mesimdhenes per lendet: Dinamika e strukturave, Metoda e elementeve te fundme(Z), Teoria e strukturave(O), Teoria e plasticitetit(Z), Inxhinieria e termeteve(Z), Mekanika I (O).

**Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit**

**Sipas konkursit me nr.2/872 të datës 22.10.2019 janë pozitat me numër rendor 1, 2 dhe 3.**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Basketboll (O), Konceptet dhe metodologjia në planifikim programim (O), Strategjit për sportin inkluziv (Z), Aftësitë e komunikimit dhe prezentimit (Z), Zhvillimi afatgjatë i sportistit (Z), Aspektet psikologjike të performances spotive (O).

2. Një Mësimdhënës për lëndët: Sportet luftarake (O), Fitnes (O).

3. Një Mësimdhënës për lëndët: Anatomi funksionale (O), Mjekësi Sportive (O).

**Fakulteti i Edukimit**

**Sipas konkursit me nr.2/872 të datës 22.10.2019 janë pozitat me numër rendor 2 dhe 21.**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Histori e letërsisë kombëtare (O), Letërsi për fëmijë (O), Letërsi për fëmijë (O), Metodologji e leximit letrar (O).

2. Një mësimdhënës: Kapituj të zgjedhur nga historia e qytetërimeve të lashta (Z), Praktika pedagogjike III (O), Edukimi për trashëgimi kulturore (Z), Histori ilire (O), Arkeologji e kohës së metaleve (O).

## II. Pozitat e personelit akademik që i takojnë kategorisë si në pikën 4 te pjesës së dytë të këtij vendimi

**Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore**

**Sipas konkursit me nr.2/872 të datës 22.10.2019 është pozita me numër rendor 25.**

1. Një asistent për grup lëndësh në kontabilitet dhe financa.

**Fakulteti i Arteve**

**Sipas konkursit me nr.2/872 të datës 22.10.2019 është pozita me numër rendor 8.**

1. Një asistent për lëndën Media dixhitale, I, II, II, IV.

**Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë**

**Sipas konkursit me nr.2/872 të datës 22.10.2019 është pozita me numër rendor 5.**

1. Një asistent për lëndët: Teknikat e përpunimit, matjeve dhe automatizimit (O), Mekanizimi Bujqësorë (O), Inxhinieria Bujqësore (O), Inxhinieria ne teknologjinë ushqimore (O) Mekanizimi i korrjes dhe përpunimit të ushqimit të kafshëve (Z).

**Sqarim:** Për këtë pozitë, nuk është dorëzuar raport i komisionit vlerësues në Administratën Qendrore të Rektoratit.

**Fakulteti i Mjekësisë**

**Sipas konkursit me nr.2/872 të datës 22.10.2019 janë pozitat me numër rendor 12, 47, 48, dhe 49.**

1. Një asistent për lëndët: Mjekesi Fizikale dhe Rehabilitim (MFR) (MP) (O), Fiz. Pers. Ekstr. Amput. (Ft) (O), Bazat e terapisë së punës (Ft) (O), Protetikë dhe ortotikë (Ft) (O), Sporti dhe rekreacioni (MP) (O) dhe Shendeti dhe rekreacioni (Ft) (O).

2. Një mësimdhënës për lëndët: Mjekësia e sportit (O), Bazat e transformimit motor III (O), Bazat e transformimit motorik I dhe II (O), Masazhë mjekësore (Z), Menaxhimi ne fizioterapi (Z), Praktike klinike I (O).

**Sqarim :** Për pozitën me nr. 2, raporti i komisionit vlerësues është dorëzuar në Administratën Qendrore të Rektoratit me datë 28.09.2020, pra pas tejkalimit të afatit ligjor për vazhdim të konkursit, respektivisht ditën kur është marrë vendimi i Senatit nr. 2/31 të datës 30.09.2020.

3. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e kineziologji me biomekanikë (O), Kineziologji klinike me kineziometri II (O), Praktikë Klinike V (grupimi I) (O), Praktikë klinike II ( grupimi I) , Menaxhimi I dhimbjes (Z).

**Sqarim :** Për pozitën me nr.3, nuk është dorëzuar raport i komisionit vlerësues në Administratën Qendrore të Rektoratit.

4. Një mësimdhënës për lëndët: Kapitujt e zgjedhur nga fizioterapia (O), Fizioterapia te personat me ekstremitete te amputuara (Z) Praktike klinike V (grupimi II) (O), Sporti i personave me aftësi të kufizur (Z), Fizioterapia ne onkologji (Z), Praktikë klinike II ( grupimi II) (O), Kineziologji klinike me kineziometri I (O).

**Sqarim :** Për pozitën me nr.4, nuk është dorëzuar raport i komisionit vlerësues në Administratën Qendrore të Rektoratit.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" • UNIVERSITY OF PRISHTINA • 1970